



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA RAJONALE TIRANË

Nr. 5929/6 prot.

Tiranë, më 05.02.2026

Lënda: Shpallje për subjektin “PLAZA CLINIC” me NIPT M51720504S.

Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Tiranë, ka realizuar një inspektim në subjektin “PLAZA CLINIC” me NIPT M51720504S, me adresë Durres Lagjja Nr.1, Rruga At Erazmi, Godina Fly, Kati 9 , Zona Kadastrale 8514, Njesi me Nr. pasurie 3/289-N36, dhe në përfundim të procesit të inspektimit në mbështetje të ligjit 9634 datë 30.10.2006 “Për inspektimin në punë”, i ndryshuar, është marrë Vendimi Përfundimtar i inspektimit me nr. ISHPSHSH-TR-2026-000329-5, datë 26.01.2026, ku ndaj subjektit janë ndërmarrë këto shkelje:

1. Neni 116 Pika 1, Ligji nr.10237 datë 18.02.20210 ” Për sigurinë dhe shëndetin në punë, i ndryshuar, Komente: Punëdhënësi nuk i ka paguar rregullisht pagën punëmarrësve nëpërmjet sistemit bankar.
2. Neni 143 Pika 1, Ligji nr.10237 datë 18.02.20210 ” Për sigurinë dhe shëndetin në punë, i ndryshuar, Komente: Punëdhënësi nuk ka respektuar afatet e njoftimit për zgjidhjen e kontratës se individuale të punës me afat të pacaktuar.
3. Neni 144 Pika 5, Ligji nr.10237 datë 18.02.20210 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë, i ndryshuar, Komente: Punëdhënësi, nuk ka respektuar procedurën e përcaktuar në nenin 144, pika 5.
4. Neni 94 Pika 5, Ligji nr.10237 datë 18.02.20210 ” Për sigurinë dhe shëndetin në punë, i ndryshuar, Komente: Punëdhënësi nuk i ka paguar pushimet vjetore që i takojnë punëmarrësit, gjatë periudhës së punësimit, as edhe pas përfundimit të mardhënieve të punës.

Në zbatim të procedurave që parashikon ligji 99/2024, datë 12.09.2024, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” njoftimi i subjektit për këtë Vendim Përfundimtar Inspektimi nuk është bërë i mundur të kryhet nëpërmjet dorëzimit personal dhe me postë..

Bazuar në nenin 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ISHPSHSH Tiranë ka vendosur njoftimin e subjektit “PLAZA CLINIC” me NIPT M51720504S dhe adresë Durres Lagjja Nr. 1, Rruga At Erazmi, Godina Fly, Kati 9 , Zona Kadastrale 8514, Njesi me Nr. pasurie 3/289-N36, për njohjen me këtë Vendim Përfundimtar të Inspektimit me anë të shpalljes së këtij njoftimi duke e afishuar në zyrat e ISHPSHSH-së Durrës, në adresën e subjektit, në

QKB, në mjediset e Drejtorisë Qëndrore të ISHPSHSH-së dhe në faqen zyrtare të ëeb të ISHPSHSH-së.

Në zbatim të pikës 3 të nenit 162 të Kodit të Procedurës Administrative, njoftimi do të vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes. Kundër Vendimit Përfundimtar të Inspektimit, subjekti "PLAZA CLINIC" ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të Vendimit Përfundimtar të Inspektimit. Ankimi paraqitet pranë Inspektoratit Qëndror të "Komisjoni i Ankimit".

Për njohjen me përmbajtjen e plotë të Vendimit Përfundimtar të Inspektimit dhe marrjen e kopjes së tij mund të paraqiteni pranë ISHPSHSH-së Durrës.

Ky njoftim shpallet sot më datë 6.02.2026 dhe do të qëndrojë i afishuar deri në datë 6.02.2026 (10 ditë) në mjediset e ISHPSHSH-së dhe në adresën e subjektit.

KRYEINSPEKTOR
Ardit Shabanaj

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
PËRGJEGJËS SEKTORI INSPEKTIMI DURRËS
Bledar Voka

